



# ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS



## PROGRAMI

Populli shqiptar, historikisht i pushtuar nga armiqë të ndryshëm, asnjëherë nuk pushoi angazhimin drejt lirisë dhe shtetit. Duke i parë rrethanat që u krijuan me krijimin e shteteve-komb në tërë Evropën, elita e popullit shqiptar, të frymëzuar nga heroi kombëtar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, në Lidhjen e Prizrenit më 1878, bashkoi të gjitha fiset në një organizim dhe komb të vetëm, duke i hapur rrugë krijimit të shtetit shqiptar.

Më 28 nëntor 1912, shpallet themelimi i shtetit shqiptar, por Fuqitë e Mëdha, për hirë të ruajtjes së paqes në Evropë, cunguan shtetin e posa krijuar, duke i ndarë pjesë të tij e duke i dhënë shteteve grabitqare fqinje. Të brengosur nga ndarja e kombit, Mbrojtja Kombëtare Shqiptare, mbajti në mobilizim kombin në të gjithë trojet e tij, duke bërë përpjekjet diplomatike dhe ushtarake drejt shtetit-komb.

Këto përpjekje i konkretizoi Ushtria Nacional Çlirimtare, e cila gjatë Luftës së Dytë Botërore, fitoi luftën kundër nazi-fashizmit. As rreshtimi i drejtë i UNÇ-së dhe rënia e dhjetëra mijëra dëshmorëve, në të gjitha trojet shqiptare, nuk ishte e mjaftueshme, që të realizohen aspiratat shekullore për liri të plotë të popullit.

Kosova, që u nda me dhunë nga trugu në vitin 1913, hoqi të zitë e ullirit nën pushtetin kolonialist sllav. Populli shqiptar i Kosovës, u vra, masakrua, dëbua e persekutua, por asnjëherë nuk e uli kokën para pushtuesit. Demonstratat e përgjithshme të viteve 1968 dhe 1981, i dhanë goditje regjimit titist dhe hapën rrugën që në vitin 1993, të themelohet Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Sakrificat e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, në Marsin e vitit 1998, shënoi mobilizimin e përgjithshëm të popullit, nën udhëheqjen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Që nga 21 qershori 1999, çizmja e fundit e okupatorit sllav, u largua përfundimisht nga Kosova.

Pas largimit të pushtuesit dhe vendosjes së faktorit ndërkombëtar, luftëtarët e UÇK-së themeluan Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, si organizatë e bashkimit vullnetar të luftëtarëve dhe përfaqësuese e idealit të luftës çlirimtare dhe Dëshmorëve të Kombit.

OVL të UÇK-së si organizatë joqeveritare dhe jopartiake, me mund të madh arriti që statusi i luftëtarëve të UÇK-së, dëshmorëve, familjeve të tyre, të njihet me ligj. Tani do të synojë avansimin e këtij statusi, sipas standardeve të shteteve të civilizuar. OVL të UÇK-së, vazhdimisht është në mbrojtje të dinjitetit dhe integritetit të Luftëtarit, duke ndikuar që të përmirësojë ligjet në fuqi, e njëkohësisht duke ndihmuar luftëtarët e familjet e tyre, në realizimin e të drejtave si dhe në mbrojtjen juridike e sociale të tyre.

E orientuar drejt kombëtarisht dhe duke i njohur rrethanat politike globale, OVL të UÇK-së, përshëndeti shpalljen e Republikës së Kosovës. OVL të UÇK-së, në vazhdimësi do të kultivojë atdhetarizmin dhe nacionalizmin shqiptar, e në këtë vijë, do të mbështet organet e Republikës së Kosovës drejt funksionalizimit të shtetit, ruajtjen e sovranitetit, tërësisë territoriale dhe në mbrojtjen e vendit nga çfarëdo rreziku.

OVL të UÇK-së, do të ndihmojë në luftimin e krimit të organizuar dhe në demaskimin e profiterëve të luftës.

OVL të UÇK-së, do të punojë që anëtarët e saj, të kenë pjesëmarrje aktive dhe ndikim në të gjitha sferat e jetës në Kosovë, duke dhënë kontributin në ndërtimin e shtetit të fortë ekonomikisht dhe ushtarakisht.

OVL të UÇK-së, do të punojë në bashkimin me Shoqatën e Invalidëve të Luftës dhe Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, në një organizim të vetëm. Gjithashtu do të vazhdojë bashkëpunimin me shoqatën e veteranëve të Luftës së Dytë Botërore si dhe shoqatat e UÇ Kombëtare dhe UÇPMB-së. Do të ofrojë mbështetje edhe për shoqatat që merren me familjet e civilëve të vrarë gjatë luftës çlirimtare, invalidëve civilë dhe të pagjeturit.

OVL të UÇK-së, do të mbrojë komplekset memoriale, lapidarët, varrezat e dëshmorëve, muzeve të luftës dhe do të marrë e përkrahë iniciativat për ndërtimin e tyre. Do të angazhohet që qytetet e mëdha shqiptare, si në shtetin amë, ashtu edhe në Republikën e Kosovës, të ngrisin shtatoren e Heroit Kombëtar Adem Jashari, si kujtim i lavdisë dhe fitores së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Duke pasur parasysh se lufta e drejt çlirimtare e UÇK-së u njoh ndërkombëtarisht, si dhe OVL të UÇK-së është anëtare e Konfederatës Evropiane dhe Federatës Botërore të veteranëve të luftës, OVL të UÇK-së do të jetë përfaqësuese e denjë e luftës sonë, në raport me faktorët ndërkombëtar.

OVL të UÇK-së, nuk do të lejojë shkeljen dhe degradimin e vlerave të luftës çlirimtare dhe do të kundërshtojë ashpër çdo tendencë të tillë nga kushdo që vjen ajo.

Duke u nisur nga aspiratat shekullore të kombit, qëllimi i luftës çlirimtare dhe ideali i patriotëve dhe dëshmorëve të Atdheut, OVL të UÇK-së, do të kontribuojë që shqiptarët në periudhën më të shpejtë e të mundshme kohore, të jetojnë nën një Atdhe, një Shtet dhe një Flamur.